

Zbuloni NATO-n

MË SHUMË INFO?
vizitoni faqen tonë:
www.nato.int



Mbrojtja e njerëzve

Në shpesh nuk i kushtojmë rëndësi faktit se mund të ecim lirisht në një mjedis të sigurtë dhe të qëndrueshëm ekonomikisht. Siguria në të gjitha zonat e jetës së përditshme është çelësi i mirëqenies sonë.

Lufta ndaj kërcënimeve të reja

Meqenëse natyra e kërcënimeve ndryshon, ashtu duhet të ndryshojnë edhe metodat për ruajtjen e paqes. NATO po orienton edhe një herë aftësitë për mbrojtje në drejtim të kërcënimeve të sotme. Ajo po adapton forcat dhe po zhvillon përpjekje shumëkombëshe për të bërë negociata me terrorizmin, shtetet e falimentuara dhe kërcënimet e tjera të sigurisë, si armët e shkatërrimit në masë.

Forcimi i partneriteteve

Vendoja e dialogut dhe kooperimi janë vendimtare, për marrëdhëniet për paqe dhe mirëkuptim të mëtejshëm ndërkombëtar.

NATO-ja siguron një mundësi të vetme për vendet anëtare dhe partnere për t'u këshilluar në lidhje me problemet e sigurisë, për të krijuar besim dhe për një periudhë afatgjatë, ndihmon në parandalimin e konfliktit.

Nëpërmjet bashkëpunimit praktik dhe iniciativave shumëpalëshe, vendet po vënë në jetë së bashku sfida të reja të sigurisë.

Ndërtimi i paqes dhe i stabilitetit

Dobitë e stabilitetit mund të gëzohen njëheri nga shumë palë. Është vendimtare që të stabilizohen rajonet ku tensionet kërcënojnë sigurinë. Ja pse NATO merr përsipër një rol aktiv në operacionet e administrimit të krizës, në bashkëpunim me organizatat e tjera ndërkombëtare.

Vendet anëtare dhe partnere

nënshkrimi i Traktatit të Atlantikut të Veriut, më 4 Prill 1949

ANËTARËT (+DATA E BASHKËPUNIMIT)

Shqipëria /2009	Letonia /2004
Belgjika /1949	Lituania /2004
Bulgaria /2004	Luksemburgu /1949
Kanadaja /1949	Holanda /1949
Kroacia /2009	Norvegjia /1949
Republika Çeke /1999	Polonia /1999
Danimarka /1949	Portugalia /1949
Estonia /2004	Rumania /2004
Franca /1949	Slovakia /2004
Gjermania /1955	Slovenia /2004
Greqia /1952	Spanja /1982
Hungaria /1999	Turkia /1952
Islanda /1949	Britania e Madhe (Anglia) /1949
Italia /1949	Shtetet e Bashkuara /1949

VENDET E PARTNERITETIT PËR PAQEN (PPR)

Armenia	Rusia
Austria	Serbia
Azerbaixhani	Suedia
Bjellorusia	Svicra
Bosnja dhe Hercegovina	Taxhikistani
Finlanda	ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë*
Gjeorgjia	Turkmenistani
Irlanda	Ukraina
Kazakistani	Uzbekistani
Republika e Kerkizisë	
Malta	
Moldavia	
Mali i Zi	

MESDHETAR BISEDIME NDËRMJET PARTNERËVE

Algjeria	Maroku
Egjypti	Tunizia
Izraeli	
Jordania	
Mauritania	

VENDET E NISMËS PËR BASHKËPUNIM TË STAMBOLLIT

Bahrejn
Kuvajt
Katar
Emiratet e Bashkuara Arabe

*Turqia e njeh Republikën e Maqedonisë me emrin e saj Kushtetues.



Çfarë është NATO?

Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut është një nga institucionet ndërkombëtare më të mëdha të botës. Ajo është një aleancë politike dhe ushtarake e cila mbledh së bashku 28 vende anëtare nga Europa dhe Amerika e Veriut.

Këto vende mbliohen për t'u këshilluar dhe për të bashkëpunuar në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Për këtë, NATO siguron një lidhje unike në mes të këtyre dy kontinenteve për bashkëpunim politik dhe siguri.

Çfarë bën NATO?



NATO është e angazhuar për mbrojtjen e anëtarëve të saj, nëpërmjet mjeteve politike dhe ushtarake. Ajo inkurajon gjithashtu këshillimin dhe bashkëpunimin me vendet që nuk marrin pjesë në NATO në një shkallë të gjerë të fushave që kanë të bëjnë me sigurinë, si reforma e mbrojtjes dhe ruajtja e paqes.

Nëpërmjet diskutimeve të saj dhe partneriteteve, NATO-ja kontribuon që të parandalojë konfliktet brenda dhe jashtë kufijve të vendeve anëtare.

Ajo nxit vlerat demokratike dhe është e angazhuar për zgjidhjen në mënyrë paqësore të mosmarrëveshjeve. Në qoftë se përpjekjet diplomatike dështojnë, ajo ka kapacitetin ushtarak të nevojshëm për të ndërmarrë administrimin e krizës dhe operacionet për ruajtjen e paqes, vetëm ose në bashkëpunim me vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare.

NATO ka gjithashtu një dimension të tretë i cili qëndron në veprimtari në fushën e planifikimit të gjendjes së jashtëzakonshme (emergjencës) civile, duke ndihmuar aleatët dhe partnerët për t'i bërë ballë katastrofave, ashtu si edhe për të nxitur bashkëpunimin në fushën e shkencës dhe të ambientit.

Çdo vend anëtar ka një delegacion të përhershëm në selinë politike qendrore të NATO-s në Bruksel. Ai është i kryesuar nga një ambasador i cili përfaqëson qeverinë e tij në konsultimet e Aleancës dhe në procesin e marrjes së vendimeve.

Këshilli i Atlantikut të Veriut është organizmi më i rëndësishëm për marrjen e vendimeve politike brenda Organizatës. Ai takohet në nivele të ndryshme dhe kryesohet nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s i cili ndihmon anëtarët që të arrijnë marrëveshjet sipas çështjeve kryesore.

Të gjitha vendimet brenda secilit nga komitetet e NATO-s bëhen nëpërmjet konsensusit. Pra një "vendim i NATO-s" është shprehja e vullnetit të përgjithshëm të të gjithë vendeve anëtare.

NATO ka shumë pak forca të përhershme, të vetat. Kur vendoset të bëhet një operacion nga Këshilli i Atlantikut të Veriut, anëtarët japin kontributin e tyre në forca mbi bazë vullnetare. Këto forca kthehen në vendet e tyre menjëherë sapo përfundohet misioni.

si funksionon NATO?

Ky është roli i strukturës së komandës ushtarake, të bashkërendisë dhe të drejtojë këto operacione. Kjo strukturë gjendet në selinë qendrore dhe në bazat e vendosura në vendet e ndryshme anëtare.

Aktivitetet e përditshme të NATO-s, strukturat civile dhe ushtarake dhe programet e investimit për sigurinë, financohen nëpërmjet buxheteve të përbashkëta, për të cilat qeveritë anëtare kontribuojnë në pajtim me një formulë shpenzimesh të vendosur bashkërisht.

